



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-29801, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Mustafë (Ramë) Lajçi, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 29/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit privat me qëllim: "Zgjerimit të Rrugës Ekzistuese" si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të zgjerimit të rrugës ekzistuese, si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr: 570-5 në sipërfaqe prej 82m² ZK Brestovik, pronë e pronarit Mustafë (Ramë) Lajçi me qëllim të zgjerimit të rrugës ekzistuese si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr. 665-6 me sipërfaqe prej 82m² ZK Brestovik pronë Komuna e Pejës.
- III. Këto prona janë dërguar për Vlerësim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në Prishtinë.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPI,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ- së
Arkivës.

